

FTESË PËR KUOTIM

REFERENCA E PROKURIMIT: "Furnizim me kuti për Arkiv"

EMRI I OFERTUESIT _____

ADRESA:	
---------	--

EMRI DHE ID E NSh-së:	Të gjitha NSh-të në Likuidim
EMRI DHE NËNSHKRIMI I KRYESUESIT TË AUTORITETIT TË LIKUIDIMIT:	Miftar Salihi Albert Matoshi

Natyra dhe fushështirja e saktë e nevojës specifike të cilën do të plotësojë prokurimi, është e cekur më poshtë.

Ky prokurim ka për qëllim blerjen e 15,000 kutive arkivimi për ruajtjen dhe organizimin e dokumenteve të Ndërmarrjeve Shoqërore që administrohen nga AKP. Kutitë duhet të kenë një gjerësi prej 10 cm dhe do të përdoren për menaxhimin e dokumenteve që janë grumbulluar pas likuidimit të ndërmarrjeve. Kjo është e nevojshme për të siguruar transferimin dhe ruajtjen e dokumenteve në Arkivat përkatëse të Zyrave Rajonale.

Afatet dhe Kushtet e Furnizimit të Mallrave dhe Shërbimeve

1.	<u>Malli apo Shërbimi i Kërkuar:</u>	Kuota kundrejt Ftesës apo/dhe specifiko/rekomando si të përshtatshme llojin e mallit apo shërbimeve për t'u prokuruar.
2.	<u>Çmimi Fiks:</u>	Çmimet e kuotuar nga Furnizuesi duhet të jenë fikse dhe të mos i nënshtrohen ndryshimeve gjatë përmbushjes së kontratës.
3.	<u>Prejardhja:</u>	Furnizuesi duhet të sigurojë vërtetimin për prejardhjen e mallit.
4.	<u>Kushtet e dërgesës:</u>	Furnizuesi duhet të kuotoj kushtet e dërgesës.
5.	<u>Kushtet e pagesës:</u>	Furnizuesi duhet të cekë kushtet e pagesës. Kushtet e njëjta duhet të ceken edhe në faturën e Furnizuesit. Furnizuesi duhet të cekë qartë nëse çmimi përfshin apo jo TVSh-në.
6.	<u>Garancioni:</u>	Furnizuesi duhet të cekë hollësitë e kushteve dhe afateve të garancionit.
7.	<u>Specifikacionet Teknike në rast të kërkesës së mallit:</u>	Furnizuesi vërteton pajtueshmërinë me specifikat e lartpërmendura. Në rast të devijimeve, Furnizuesi duhet të cekë të gjitha këto devijime kundrejt: (i) Përshkrimin e Përgjithshëm të Mallit të kërkuar, (ii) Detajet specifike dhe standardet teknike të kërkuara, (iii) Parametrat e Kërkuar të Performancës.
8.	<u>Mospërmbushja:</u>	Blerësi mund të aplikoj ndëshkim (penalti) për mos përmbushje të kushteve të kontratës (deri në 10% të vlerës së përgjithshme të kontratës).